



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.17/2026

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryesues, Arsim Hamzaj dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër kandidates për deputete Pranvera Isufi Kameri nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen me date 07 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 05.06.2026, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ankesa ZP.Anr.17/2026 e datës 04.06.2026 e paraqitur nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër kandidates për deputete Pranvera Isufi Kameri nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen me date 07 Qershor 2026.

A r s y e t i m

Me datë 04.06.2026, PZAP-i ka pranuar një ankesë e identifikuar si ZL.Anr.17/2026 nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në të cilën pretendohet se me datë 1 Qershor kandidatja për deputete nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Pranvera Isufi Kameri me numër 47 në listën e deputeteve të subjektit politik të lartcekur ka shfrytëzuar hapësirat dhe resurset publike për qëllime të fushatës zgjedhore. Tutje, parashtruesi i ankesës thekson se në materialet e publikuara nga kandidatja në fjalë shihet se kërkohen votat dhe mbështetje për zgjedhjet nacionale nga Zyra e Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës, përkatësisht nga një hapësirë zyrtare institucionale e financuar me mjete publike. Sipas parashtruesit të ankesës, ky veprim përbën shkelje të nenit 36 të LZP-së, i cili ndalon përdorimin

e burimeve publike, objekteve publike dhe pozitës zyrtare për qëllime të fushatës zgjedhore dhe përfitim elektoral dhe se përdorimi i zyrës së Kryetarit të Komunës për promovim të kandidaturës dhe kërkim të votave krijon avantazh të padrejtë në garën zgjedhore dhe cenon parimin e barazisë së subjekteve dhe kandidatëve në procesin zgjedhor.

Si prova, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur foton dhe përshkrimin në rrjetin social "Facebook" dhe linkun e videos: <https://www.facebook.com/reel/1362504129161116>

Andaj, parashtruesi i ankesës duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura kërkon nga PZAP-i masën e sanksionit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në përgjigjen në ankesë, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) sqaron se ankesa nuk është mbështetur me prova të mjaftueshme për të vërtetuar pretendimet pasi që shkëlja e supozuar rezulton nga një video e publikuar në rrjetin social "Facebook" mirëpo të njëjtës nuk i është bashkangjitur videoja si provë materiale dhe se në ankesë është vendosur vetëm një link elektronik pa u dorëzuar incizimi përkatës në CD apo ndonjë formë tjetër që do t'i mundësonte PZAP-së shqyrtimin e drejtpërdrejtë të provës së pretenduar. Tutje, në përgjigje LVV thekson se në momentin e paraqitjes se kësaj përgjigjeje, linku i referuar në ankesë nuk është funksional dhe nuk mund të verifikohet përmbajtja në të cilën mbështeten pretendimet ankimore. Poashtu, LVV shton se edhe po të merrej për bazë fotografia e bashkangjitur ankesës, nga ajo nuk mund të konstatohet se është përdorur ndonjë resurs publik për qëllime elektorale dhe se ankuesi nuk ka paraqitur asnjë provë që do të dëshmonte përdorimin e personelit komunal, mjeteve financiare publike, infrastrukturës institucionale apo çfarëdo pasurie publike për përfitim elektoral. Andaj, LVV kërkon nga PZAP që ta refuzoj si të pabazuar ankesën për shkak të mungesës së provave relevante dhe mos vërtetimit të elementeve përbërëse të shkëljes së pretenduar.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

-Ankesa është e pasafatshme.

Paneli, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstatoi se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 39, paragrafi 3 i LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesës është 48 orë nga ndodhja e shkëljes së supozuar. Në rastin konkret nga provat e prezantuara nga pala ankuese e njëjta thekson se shkëlja ka ndodhur me datën 01.06.2026, ndërsa pala ankuese ankesën e ka dorëzuar në PZAP me datën 04.06.2026, e që nënkupton se ankesa në fjalë është paraqitur pas afatit ligjor prej 48 orësh nga ndodhja e shkëljes së supozuar e që datë e fundit për t'u parashtruar kjo ankesë ka qenë data 03.06.2026.

Paneli, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore ka gjetur se ankesa e parashtruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të paraqitur kundër kandidates për deputete Pranvera Isufi Kameri nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 39 paragrafi 3 i Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), në të cilin nen në

mënyrë decisive thuhet se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, mund të paraqes ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe PZAP-i, do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga koha e pranimit të saj, si dhe neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se “PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim, nën paragrafi 3.2. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor”.*

Me dispozitën e nenit 9 paragrafi 5 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave, parashihet që: *“Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara, ndërsa nën paragrafi 5.5 parasheh që: “për shkeljet e pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët”.*

Paneli ka gjetur se ankesa është parashtruar pas afatit të paraparë ligjor dhe duke u bazuar në nenin 39, paragrafi 3 të LZP-së, nenin 9 paragrafi 5 dhe nenin 13 paragrafi 3 pika 3.2 të Rregullës 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.17/2026, datë 05.06.2026

Kryesues i Panelit
Skender Çoçaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi